



Pranuar / Dorezuar Punë/Proclato Received/Delivered	18.12.2020	viti god year	0
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMISHK	3204/2020		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.343/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Hysni Mustafa, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar Ankesën A.Nr.343/2020 të datës 05.11.2020, e parashtruar nga ankuesja [REDACTED] me adresë banimi Rr. "Eqrem Çabej" Llam Nr.3, Hyrja 4, Nr.6, Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar ma ankesën A.nr.343/2020 të datës 05.11.2020, e parashtruar nga ankuesja [REDACTED]

A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED] e punësuar në vendin e punës "Inspektor i Ndërtimit", me datë 05.11.2020, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokoll 2450/2020, me kërkesë që Këshilli të shpall te pavlefshëm Vendimin Nr.566/2020 të datës 21.10.2020, lidhur me deklarimin e statusit të nëpunësit civil, deri sa Gjykata Themelore të vendos lidhur me statusin e saj dhe vendin e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.11.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Graçanicës, ndërsa më datë 24.11.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë dhe shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 05.11.2020 me numër protokoll 2450/2020, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje e datës 10.11.2020; Vendimi

i datës Nr.5666/20 i datës 21.10.2020 i Udhëheqëses së personelit të Komunës së Graçanicës; Njoftimi i datës 24.10.2019; Përgjigja në kërkesë e datës 24.11.2020; Kontrata e punës Nr.79/10 e datës 17.09.2010; Vendimi Nr.152 i datës 01.11.2010; Akt emërimi i ankueses i datës 01.06.2012; Aktvendimi nr.4193/17 datës 27.06.2017; Vendimi i KPMSHCK-së A.nr.524/2019 i datës 26.11.2020; Njoftimi i datës 24.10.2019; Vendimin A/02/569/2015; Aktgjykim A.nr.306/16 A.nr.229/16.

Kolegji, pasi ka shtjelluar më vëmendje shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, ka konstatuar që të përfundohet procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankueses [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] A.nr.343/20200 të datës 05.11.2020, *sepse*:

Bazuar në historinë e çështjes së shqyrtuar, kolegji ka gjetur ketë gjendje të fakteve: Ankuesja, me datë 04.12.2015 ka parashtruar ankesë me Nr. Protokolli 4350/2015 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, kundër Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Graçanicës, me të cilën është vërtetuar vendimi i Komisionit Disiplinor të Komunës së Graçanicës Nr. 6267/15 i datës 16.10.2015. Me vendimin e Komisionit Disiplinor ankueses i është shqiptuar masa disiplinore "Suspendim për kryerjen e detyrave dhe pezullimin e 1/3 të pagës në kohëzgjatje prej 30 ditësh" si dhe "transfer në zyrë tjetër dhe ndalim gradimi deri në pesë(5) vjet". Këshilli, me datë 29.01.2016 ka nxjerr Vendim A/02/569/2015 me të cilin ka aprovuar si të bazuar ankesën e datës 20.10.2015, ka shfuqizuar Vendimin Nr. 6818/15 të datës 20.11.2015 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Graçanicës, ka shpall si akt të pavlefshëm Aktvendimin Nr.6267/15 të datës 20.10.2015 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Graçanicës dhe ka obliguar Kryetarin e Komunës së Graçanicës që ankuesen ta kthejë në vendin e saj të punës .

Ankuesja si dhe Komuna e Graçanicës, kundër vendimit A/02/569/2015 të datës 29.01.2016 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kanë parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, e cila më datë 05.12.2018 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.306/16, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], ndërsa më Aktgjykimin A.nr.229/16 të datës 09.07.2019, ka aprovuar kërkesëpadinë e Komunës së Graçanicës, duke e anuluar vendimin e Këshillit dhe duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional në mungesë të kuorumit, ndërsa pas zgjedhjes së pesë anëtarëve nga Kuvendi i Kosovës, dhe pas shqyrtimit të bazës ligjore, Këshilli me Vendim Nr. 9/2020 të datës 09.11.2020, ka vendosur që të gjitha ankesat e dorëzuara dhe ato të kthyer në rishqyrtim nga gjykata gjatë kohës së mosfunksionimit, do të shqyrtohen nga Këshilli. Në pajtim me këtë, Këshilli duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore A. 229/19 të datës 09.07.2019, me Vendimin A.nr.542/2019 të datës 26.11.2020, ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankueses A.nr. 02/569/2015 të datës 04.12.2015, ka shfuqizuar Vendimin Nr.6818/15 të datës 20.11.2015 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Graçanicës dhe aktvendimin Nr. 6267/15 të datës 20.10.2015 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Graçanicës.

Nga shkresat e lëndës respektivisht sipas shkresës nr. Protokolli 6585/20 të datës 04.12.2020, Kolegji ka konstatuar se Komuna e Graçanicës bazuar në Vendimin e Këshillit A/02/569/2015

te datës 29.01.2016, ka anuluar vendimin e Komisionit Disiplinor Nr. 6267/2015 dhe Vendimin e Komisionit Për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Nr. 6818/15, ndërsa konfirmon se ankuesja është duke ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë sipas Akt Emërimit te datës 01.06.2012.

Po ashtu, Kolegji ka konstatuar së Komuna e Graçanicës me vendimin Nr.5666/20 të datës 21.10.2020, bazuar në nenin 83 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka deklaruar statusin të shërbyesit civil të ankueses, e sistemuar në vendin e punës inspektor i ndërtimit në kuadër të Drejtorisë për Inspektim.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe bazuar ne nenin 101 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji ka konstatuar që të përfundohet procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr. 343/2020 të datës 05.11.2020.

Sipas dispozitave ligjore të nenit 101 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcaktohet "Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike,...", Në këtë kuptim, rrjedhë se kërkesa e ankueses sipas parashtrësës së datës 05.11.2020, bazohet në qëllimin dhe situatën e njëjtë faktike te parashtruar nga ankuesja në ankesën Nr. Protokolli 4350/2015 të datës 04.12.2015, e për të cilën ankesë Këshilli ka vendosur me Vendimin Nr. 542/2019 të datës 26.11.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, bazuar në atë që u tha si më lartë dhe bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.343/2020

Hysni MUSTAFA

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses ██████████
- Kryetarit të Komunës së Graçanicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Graçanicës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.